



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.863/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari- kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani -anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses , ka shqyrtuar ankesën A.nr.863/2022 të datës 05.10.2022 e parashtruar nga ankuesi me adresë kundër organit të punësimit/Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike “shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 08.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.863/2022 e datës 05.10.2022 e parashtruar nga ankuesi**
- II. Obligohet Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të inicioj veprimet e nevojshme ligjore për harmonizimin e koeficientit të nëpunësit civil nga koeficienti gjashtë (6) në koeficientin tetë (8).**
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

A r s y e t i m

Ankuesi është i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, sipas Akt emërimit të datës 03.02.2020 në pozitën “Inspektor i komunikacionit”, në Drejtorinë e Inspeksionit. Me datën 22.09.2022 përmes shkresës me numër 01-120/04-0087010/2/22, i është drejtuar me kërkesë Zyrës së Personelit në Komunën e Mitrovicës, lidhur me harmonizimin e koeficientit nga gjashtë (6) në koeficientin tetë (8). Ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore të kësaj komune me datën 26.09.2022 përmes shkresës me numër 01-120/04-0087010-2/2022 i është përgjigjur ankuesit lidhur me kërkesën e tij për harmonizimin e koeficientit dhe e ka refuzuar të njëjtën.

I pakënaqur me përgjigjen e Komunës së Mitrovicës së Jugut konkretisht Zyrës së Burimeve Njerëzore, me datën 03.10.2022 përmes Postës së Kosovës ankuesi ka parashtruar ankesën



A.nr.863/2022 me numër të protokollit 5896/2022 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila në Këshill është pranuar me datën 05.10.2022, me pretendimet ankimore për harmonizimin e koeficientit nga gjashtë (6) në koeficientin tetë (8) për shkak të shkelleve të dispozitave materiale, dispozitave procedurale dhe diskriminimit në shpërbllim të pagës konform kategorisë, nivelit profesional dhe gradës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 11.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 6081/2022 në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Ndërsa Këshilli, me datën 12.02.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës nga Komuna e Mitrovicës së Jugut.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5896/2022 të datës 05.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigjen me numër reference 01-120/04-0087010-2/22 të datës 26.09.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës; Konkursin me numër reference RN00009989 të datës 23.09.2022; Konkursin me numër të referencës RN00009981 të datës 23.09.2022; Konfirmimin për disponueshmerin e mjeteve financiare me numër reference 04-400/03-0073133-2/22 të datës 02.08.2022; Formularët e shpenzimeve të departamentit, divizionit ose sektorit të datës 08.08.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 6081/2022 të datës 11.10.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 611/2022 të datës 12.10.2022; Akt emërimit të datës 03.02.2020; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 05.08.2019; Kërkesën për harmonizimin e koeficientit të pagës nga koeficienti aktual i pagës gjashtë (6) në koeficientin tetë (8) të Menaxherit të personelit të datës 22.09.2022; Fletë kthesën e datës 30.09.2022; Listën e pagave për periudhën kohore 01.08.2022 deri me datën 31.08.2022; Listën e pagave për periudhën kohore 01.09.2022 deri me datën 31.09.2022

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit, **është e bazuar, SEPSE:**

Lidhur me pretendimin e ankuesit për harmonizim të koeficientit të pagës për pozitën e *Inspektorit të Komunikacionit*, Kolegji ju referua nenit 19 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë më të cilin është përcaktuar se: *"Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërbllim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave"*, si dhe nenit 3 paragrafit 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë më të cilin parashihet se: *"Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë"*. Andaj mbi këtë bazë ligjore e nisur nga konstatimi si më lartë se ankuesi është emëruar në pozitën *Inspektor i Komunikacionit* me koeficient gjashtë (6) të pagës, si dhe duke u bazuar në shkresën e datës 19.08.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik si organ përgjegjës për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për pagat e zyrtarëve publikë, me të cilin është konfirmuar se pozita inspektor-klasa profesionale 1, ka të përcaktuar koeficientin tetë (8) të pagës, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit për harmonizimin të koeficientit të pagës me titullin e punës është i drejtë dhe i ligjshëm.

Ndërlidhur me pretendimin ankimor si më lartë, Kolegji duke u bazuar në provat e lëndës ka gjetur se Komuna e Mitrovicës së Jugut konform kërkesës së ankuesit të datës 22.09.2022 lidhur me



harmonizimin e koeficientit prej gjashte (6) në tetë (8), të njëjtën e ka refuzuar me datën 26.09.2022 përkundër pranimit të shkresës zyrtare përmes e-mailit zyrtar të datës 19.08.2022 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ku përcaktohet se pozita e *Inspektorit-në kategorinë profesional 1 duhet të jetë me koeficient të pagës tetë (8)*, kështu që mbi bazën e këtyre fakteve rrjedhë se mos harmonizimi-zbatimi i koeficienteve të ndryshëm të pagës për pozitë të njëjtë të punës sipas Rregullores Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, rrjedhimisht në gjykimin e Kolegjit veprimet e tilla bien ndesh edhe me dispozitat e nenit 2 dhe 4 të Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi si dhe nenin 7 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin parashihet se: *"Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe pëanësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë..."*, kështu që Kolegji vlerëson se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit mbi bazën e harmonizimit të koeficientit të pagës me zyrtaret tjerë të nivelit të njëjtë brenda komunës.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon e ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.863/2022,

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Jugut dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

